URDHËR
Nr. 583, datë 13.11.2025

PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR JOPUBLIK, TË NIVELIT TË ARSIMIT BAZË, SHKOLLA "RREZE DRITE"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 26 dhe 42, pika 7, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe urdhrit nr. 497, datë 29.9.2025, të ministrit të Arsimit, "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit, znj. Orjana Osmani",

URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar jopublik, të nivelit të arsimit bazë, Shkolla "Rreze Drite", licencuar me urdhrin nr. 72, datë 26.7.1999, të ministrit të Arsimit dhe Shkencës, "Për dhënien e lejes së funksionimit të institucionit arsimor jopublik".
2. Institucioni arsimor parauniversitar jopublik, i nivelit të arsimit bazë, Shkolla "Rreze Drite", ka për detyrë:
a) Të kthejë pagesat e kryera nga prindi/përfaqësuesi ligjor i nxënësit për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbushur, nëse ka.
b) Të pajisë çdo nxënës me dokumentacionin e nevojshëm shkollor, që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit parauniversitar.
c) Të vërë në dispozicion të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar, Tiranë, çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë urdhër.
d) Të dorëzojë në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar, Tiranë, të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë e kryer.
3. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Tiranë, ka për detyrë:
a) Të ngrejë grup pune brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri dhe të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar jopublik, të nivelit të arsimit bazë, Shkolla "Rreze Drite".
b) Të marrë masa për transferimin e të gjithë nxënësve të regjistruar në këtë institucion arsimor në institucione të tjera të arsimit parauniversitar.
c) Të administrojë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga institucioni arsimor parauniversitar jopublik.
d) Të ruajë në arkivin e institucionit dhe më tej të arkivojë sipas ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, "Për arkivat", i ndryshuar, dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni arsimor parauniversitar jopublik, i nivelit të arsimit bazë, Shkolla "Rreze Drite".
4. Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare Tiranë të monitorojnë veprimtarinë e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë për zbatimin e detyrave, sipas këtij urdhri.
5. Në rast të moszbatimit të detyrimeve nga institucioni arsimor parauniversitar jopublik, i nivelit të arsimit bazë, Shkolla "Rreze Drite", të përcaktuara në pikën 2, të këtij urdhri, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Tiranë, të marrë të gjitha masat, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Urdhri nr. 72, datë 26.7.1999, i ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për dhënien e lejes së funksionimit të institucionit arsimor jopublik”, shfuqizohet.

7. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare, Tiranë, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Tiranë, institucioni arsimor parauniversitar jopublik, i nivelit të arsimit bazë, Shkolla “Rreze Drite”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
Orjana Osmani